



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 526/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Vedat Poterqoi- Kryetar, Agon Ramadani- referues, Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik GOE "Termovizioni Sh.P.K & N.N.Infra-Plus" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "INSTALIMI I NGROHJES QENDRORE NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT DHE SHITËPINË E KULTURËS NË RAHOVEC", me nr. të prokurimit: 623-22-8319-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Kuvendi Komunal Rahovec, me datën 21.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "GOE "Termovizioni Sh.P.K & N.N.Infra-Plus" - Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 10.10.2022 me numër të protokollit 526/2022, për aktivitetin e prokurimit: "INSTALIMI I NGROHJES QENDRORE NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT DHE SHITËPINË E KULTURËS NË RAHOVEC", me nr. të prokurimit: 623-22-8319-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Kuvendi Komunal Rahovec.

II. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për aktivitetin prokurimit të precizuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Me qenë se ankesa e OE ankues, është refuzuar si e pa bazuar, konfiskohet depozita kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me 23.09.2022, Autoriteti Kontraktues – KK Rahovec, ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “INSTALIMI 1 NGROHJES QENDRORE NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT DHE SHITËPINË E KULTURËS NË RAHOVEC”, me nr. të prokurimit: 623-22-8319-5-2-1.

Me datën 28.09.2022, GOE “Termovizioni Sh.P.K & N.N.Infra-Plus” - Prishtinë, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK me vendim me datën 30.09.2022.

Me 10.10.2022 GOE “Termovizioni Sh.P.K & N.N.Infra-Plus” - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 526/22), kundër njoftimit për dhënies të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 17.10.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

- Ankesa e OE të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Pretendimi ankimor - 1: GOE ankues pretendon që KK-RAHOVEC ka bërë shkelje të nenit 1, të LPP-së pasi që oferta e Grupi i Operatorëve: EKO SYSTEM SH.P.K & H&b Consulting SH.P.K nuk ka qenë administrativisht e përgjegjshme dhe përkundër asaj është shpërblyer me kontratë. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, pasi që GOE i rekomanduar për kontratë, nuk ka arritur të përgatitë ofertën në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosje të tenderit nga AK, dhe atë mbi Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Andaj pretendimi ankimor i GOE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

GOE ankues pretendon që: “Autoriteti kontraktues, KK-RAHOVEC, gjatë vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të përgjithshme të LPP-së pasi që nuk e ka ruajtur parimin e trajtimit dhe barazimit jo-diskriminimi, AK me këtë veprim ka bërë diskriminim të OE pasi që nuk ka marr për bazë kërkesën në FDT ku sipas kërkesës OE duhet të ofroj: Dy punëtorë të certifikuar si Saldues, të trajnuar dhe certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1 me certifikata valide;

Pas shikimit të dokumentacionit tenderues kemi vërejtur se të dy grupet e operatorëve ekonomik: Grupi i Operatorëve: EKO SYSTEM SH.P.K & H&B Consulting SH.P.K. dhe Grupi i Operatorëve: HARST GROUP SH.P.K & ECOTERMA SH.P.K nuk e plotsojnë kërkesën e lartcekur sipas rregullave dhe kërkesave ISO standardeve kryesisht për ISO 9606-1 për saldator. Grupi i Operatorëve: EKO SYSTEM SH.P.K & H&B Consulting SH.P.K ka dorëzuar ASQ CERT certifikatën PA AFAT (JO VALIDE) me AQS/T/S 19942019 për z. Ernad Gashin dhe certifikatën PA AFAT (JO VALIDE) me AQS/T/S 19952019 për z. Fadil Krasniqi të dyja të lëshuara me datë 27.11.2018 ç’ka do të thotë se kanë kaluar afatin prej tre vjetëve.

Duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmi të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, meqë nuk janë përmbushur kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosje të tenderit nga AK. Duke u bazuar me Dëshmitë e dokumentuara për kërkesat e përshtatshmërisë, mbi Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ekspert i shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor i GOE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

GOE ankues pretendon që: “Pretendim yni mund të vërtetohet lehtë edhe duke u bazuar në certifikatat e Grupit i Operatorëve: HARST GROUP SH.P.K & ECOTERMIKA SH.P.K ku i njëjti nga ASQ CERT ka certifikatën ME AFAT (VALIDE) me AQS/T/S 707020202021 për z. Endrit Brahaj e lëshuar me datë 06.03.2021 dhe data e skadimit 05.03.2024 dhe është brenda afatit nga data e lëshuar janë me pak se tri vite dhe certifikatën PA AFAT (JO VALIDE) me AQS/T/S 40602020 për Mërgim Berisha e lëshuar me datë 27.11.2018 me më shumë se tri vite.

Nisur nga sa u tha më lart shihet se veprimet e tilla janë plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së si dhe në kundërshtim edhe me dispozitat tjera të LPP-së duke mos trajtuar në mënyrë të drejtë OE.

Duke u bazuar në standardin ISO 9606-1 kërkohet që saldatori të ri-testohet çdo 3 vite, në rastin konkret në Certifikatën e z. Mërgim Berisha lëshuar me datë 27.11.2018, nuk është gjetur dëshmi të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim të një ri-testimi të tillë, ashtu si është e paraparë me standardin ISO 9606-1. Certifikata e lëshuar është e kualifikimit fillestar, mirëpo vlefshmëria e certifikatës, rivalidimi dhe rivlerësimi i kualifikimit të Saldatorit duhet të behet ashtu si është e paraparë me standard.

Në vendimin e AK të datës 30.09.2022 për Rishqyrtim të Kërkesës së GOE ankues të datës 28.09.2022, AK ka bërë kërkesë për sqarim nga kompania AQSCERT, sa i përket validitetit të Certifikatave të lëshuara nga kompania. Kompania ka konfirmuar që certifikatat e trajnimit për Saldator për z. Ernad Gashi dhe z. Fadil Krasniqi të lëshuara me datë 27/11/2018 janë valide. mirëpo, këto certifikime për të plotësuar kërkesën e parashtruar në dokumentet e tenderit (Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë), duhet të plotësojnë standardin ISO 9606-1. Certifikata

e lëshuar është e kualifikimit fillestar, mirëpo vlefshmëria e certifikatës, rivalidimi dhe rivlerësimi i kualifikimit të Saldatorit duhet të behet ashtu si është e paraparë me standard, që duke u bazuar në standardin ISO 9606-1 kërkohet që saldatori të ri-testohet çdo 3 vite, dhe po të shikohet në anën e djathtë të certifikatës, afër datës së lëshimit shkruan data e ri lëshimit, që mund të kuptohet që këto certifikata është dashur t'ju vazhdohet afati.

Nuk është e qartë sa i përket Kompanisë që e lëshon certifikimin, se pse për disa kandidatë është shënuar data e lëshimit dhe skadimit të certifikatës, për periudhë tre vjeçare ashtu si është e paraparë me Standardin EN ISO 9606-1 dhe për disa të tjerë që këto certifikime janë bërë më herët, në vend të datës së skadimit, shkruan data e ri lëshimit.

Andaj, Eksperti Shqyrtues thekson që duke marrë parasysh, nga çka u tha më lartë ku pretendim ankimor është **i qëndrueshëm, i bazuar**.

Oferta e EKO SYSTEM SH.P.K. & H&b Consulting SH.P.K nuk plotëson të gjitha kërkesat e AK-së që i ka parashtruar në njoftimin për kontratë dhe me dosjen e tenderit andaj shihet qartë se AK nuk ka respektuar pikën e nenit 59.4 por nuk ka respektuar as kërkesat që vet i ka parashtruar më parë. Kjo tregon se vlerësimi nuk është kryer aspak sipas kërkesave të LPP-së me çka dëshmohet qartë se AK ka shkelur nenin 59 të tij,

Eksperti Shqyrtues pas verifikimit dhe vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit, konsideron se pretendimi që ka të bëjë me: “....AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së sepse gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar aspak nenin 59.4 të LPP-së”, është **i qëndrueshëm, i bazuar**. Deri të ky përfundim, eksperti shqyrtues ka ardhur, pas analizimit të dosjes së tenderit, duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. GOE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat që kanë qenë në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.

Eksperti Shqyrtues sqaron se në nga çka u tha më lartë, konsideron se ky Aktivitet i Prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim, ku AK në bazë të kompetencave të vazhdojë procesin e rivlerësimit konform dispozitave LPP-së.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e GOE “Termovizioni Sh.P.K & N.N.Infra-Plus” - Prishtinë, të aprovohet si e bazuar dhe rekomandon që të anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast OE ankues pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritohet të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Lidhur me pretendimin e Ankuesit se Certifikatat e trajnimit të salduesve të OE të rekomanduar nuk kanë validitet, OSHP ka hulumtuar në faqen publike të këtij entiteti me qëllim të vërtetimit të

drejtë gjendjes faktike dhe ka gjetur se certifikatat e lëshuara nuk parashohin kufizime për periudhën e vlefshmërisë. Nga ky aspekt OSHP mori në konsideratë veprimet e AK dhe vlerësimet e tij, në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të kësaj lënde dhe qëllimit të aktivitetit të prokurimit.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në rastin konkret në harmoni me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP, prandaj në këtë rast nuk ka bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim, sepse në të kundërtën kjo do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesues i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK RAHOVEC;

1x1 GOE "Termovizioni Sh.P.K & N.N.Infra-Plus" - Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.